

## Ofrimi i shërbimeve cilësore sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre

### Termet e Referencës

|                              |                                |
|------------------------------|--------------------------------|
| <b>Titulli</b>               | Punëtorë/e Social/e (2 pozita) |
| <b>Lloji i kontratës</b>     | Me kohë të caktuar             |
| <b>Lokacioni</b>             | Prishtinë, Kosovë              |
| <b>Periudha e angazhimit</b> | 01 Korrik 2018 – 31 Gusht 2019 |

### HANDIKOS

HandiKOS, është organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 1983, që përfaqëson dhe përkrah personat me aftësi të kufizuar në Kosovë duke avokuar, lobuar dhe duke ofruar shërbime përmes rrjetit të shtrirë në të gjithë Kosovën për të arritur të drejta të barabarta, një jetë të pavarur dhe të dinjitetshme për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

HandiKOS ka një shtrirje të gjerë në të gjithë Kosovën përmes qendrave të rehabilitimit të bazuar në bashkësi në **14 komuna dhe 12 zyre lokale**, në të cilat ka pilotuar dhe ofruar një sërë modelesh të shërbimeve sociale të bazuara në bashkësi.

HandiKOS në strategjinë e saj 5 vjeçare (2018-2022) ka përcaktuar këto objektiva strategjike: *pjesëmarrja; punësimi; edukimi; mirëqenia sociale; shëndeti; dhe zhvillimi organizativ.*

HANDIKOS është licencuar për shërbime sociale dhe familjare, përkatësisht për shërbime për personat me aftësi të kufizuara fizike dhe të kombinuara, posedon edhe staf të licencuar, Hapësira të mjaftueshme dhe të qasshme për personat me aftësi të kufizuara, pajisje rehabilituese dhe didaktike për ofrim të shërbimeve, si dhe automjete të mjaftueshme dhe të qasshme për personat me aftësi të kufizuara.

Pozita në fjalë do i kontribuojnë HANDIKOS në implementimin e projektit *Ofrimi i Shërbimeve Cilësore Sociale për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara* projekt ky i mbështetur nga Bashkimi Evropian, ndërsa i implementuar në partneritet me Save the Children Kosovo.

- **Detyrat dhe përgjegjësitë**

Detyrat dhe përgjegjësitë e punëtorit/ës social/e janë:

- Kontribuon dhe implementon kurrikulat e trajtimit për fëmijët me aftësi të kufizuara
- Mbron fëmijët nga të gjitha format e abuzimit
- Mbështet familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara
- Krijon lidhje bashkëpunuese ndërmjet ofruesve të shërbimeve relevante me aftësinë e kufizuar
- Koordinon dhe mbanë takime të rregullta me Komitetin Drejtues të projektit
- Raporton në baza mujore për arritjet e fëmijëve
- Kontribuon në implementimin e programeve të HANDIKOS
- Mbështet fëmijët në procesin e zhvillimit
- Kontribuon dhe implementon Planet Individuale të Intervenimit

**Kualifikimi dhe eksperiencia**

Edukatori/ja duhet të ketë:

- Diplomë Universitare në shkencë sociale (Pedagogji Speciale; Edukim Special; Psikologji; Punë Sociale) – vlerë e shtuar
- Dëshmi e përvojës së punës në fushën përkatëse (fëmijë, fëmijë me aftësi të kufizuar);
- Njohuri për parimet e të drejtave të fëmijëve të bazuara në KDF dhe KB;
- Licencë për ofrimin e shërbimeve sociale - vlerë e shtuar
- Njohja e gjuhës angleze (vlerë e shtuar)
- Njeh zhvillimin tipik të fëmijëve
- i/e aftë të punoj me grupe të fëmijëve
- Njeh kontekstin kulturor të familjeve kosovare
- Leja e qarkullimit – Kategoria B

**Aplikuesi/ja duhet të dorëzojnë**

- Letër motivimi, dëshmi që ai / ajo është i/e përshtatshme dhe ka njohuri dhe eksperiencë në ofrimin e shërbimeve për fëmijë me aftësi të kufizuara;
- Curriculum Vitae (CV);
- Dëshminë që nuk jeni nën hetime
- Dy (2) letra reference nga punëdhënësit e fundit (nëse është e aplikueshme)

## **Procedurat e aplikimit dhe përzgjedhja**

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në: [handikos@handi-kos.org](mailto:handikos@handi-kos.org) me subjektin *Punëtorë/e Social/e - 11005*. Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është 03 Korrik 2018, h16:30.

*Vetëm kandidatët në listën e ngushtë do të kontaktohen për fazën e dytë të rekrutimit, nuk ofrohen informata përmes telefonit.*

**HandiKOS mbron fëmijët nga të gjitha format e abuzimit, andaj çdo rekrutimi të mundshëm i kushton vëmendje të veçantë këtij aspekti. Për këtë arsye, atëherë kur ju do të njoftoheni për intervistën, Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve e HANDIKOS do ndahet me ju për lexim.**

**Kandidatët e suksesshëm para nënshkrimit të kontratës do iu nënshtrohen edhe trajnimit për Mbrojtjen e Fëmijëve.**

